## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

*ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

*Për:* **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

*Për Aktivitetin e Prokurimit*

**Titulli: Shërbime për Deratizim,Dezinfektim,Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare –Ri tender**

| | |
|---|---|
| **Nr i prokurimit** | **214-23-13757-2-1-1** |

### *1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK*

***GOE.Besim A.Zejnullahu B.I*** ; **TRESOR HOME L.L.C**
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Rr.Reqakut,p.n*
*(Adresa)*
***Ferizaj***
*(Vendi)*
***70000***
*(Kodi postar)*
***044138490***
*(Numri Telefonit)*
*(Numri i Faks-it)*

***Besim Zejnullahu***
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*
***ekoddd@hotmail.com***
*(Adresa elektronike)*

*05.07.2024*
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

BESIM A. ZEJNULLAHU B.I.
"EKO-DDD"
FERIZAJ

*(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

- *Njoftimi per kontrate dt.18.12.2023*
- *Afati i fundit per dorezim te tenderit dhe hapje te tenderit 07.05.2024*
- *Njoftimi per vendimin per dhenje te kontrates 21.06.2024*
- *Tenderi i pergjegjshem me Çmim me te ulet*
- *Njoftimi për dhënie të kontratës dhe letrën standarde për tenderuesit e pa sukseshëm me dt.21.06.2024*
- *Kërkesa për ri-shqyrtim me dt.25.06.2024*
- *Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim me dt.28.06.2024*

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

*Kundër vendimit për dhënje të kontratës kemi parshtruar kërkesë për ri-shqyrtim tek AK-* **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** *me dt. 25.06.2024.*

*AK-* **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** *me dt. 28.06.2024 na njofton me vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit :* **Shërbime për Deratizim,Dezinfektim,Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare –Ri tender** *" nr i prokurimit* **214-23-13757-2-1-1** *" me arsyetimin se kerkesa per ri-shqyrtim eshte e pa bazuar.*

*Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP parashtroj ankesë kundër vendimit për refuzim të kërkesë për ri-shqyrtim si dhe kundër njoftimit për dhënie të kontratës dhe letrës standarde si OE i eleminuar .*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- **Dispozitat e shkelura:**
- **Neni 1 i LPP**
- **Neni 6 i LPP**
- **Neni 7 i LPP**
- **Neni 28 i LPP**
- **Neni 51 i LPP**
- **Neni 56 i LPP**
- **Neni 59 i LPP**
- **Neni 60 i LPP**
- **Neni 69 i LPP**
- **Neni 69.4 i LPP**
- **Neni 71 i LPP**
- **Neni 72 i LPP**
- **Neni 108/A i LPP**
- **Vendimi i OSHP-se nr** 2023/0642 të datës 08.12.2023dhe vendimi nr 2023/0626 të datës 03.11.2023
- **Interpretimi Ligjor i KRPP-se i** datës 07.06.2024 me nr.KRPP-DRR-07-06-88/2024

*të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-ës parashtrojmë këtë ankesë kundër vendimit të AK – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** mbi refuzimin e kërkesës tonë për ri-shqyrtim si dhe njoftimit për dhënie të kontratës **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K** si OE i përgjegjshëm lidhur me aktivitetin e prokurimit : **Shërbime për Deratizim,Dezinfektim,Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare –Ri tender**" *nr i prokurimit* **214-23-13757-2-1-1**"

AK me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës sone nuk ka vepruar konform nenit 108A të LPP me qëllim të evitimit të gabimeve me rastin e vlersimit ,ekzminimit dhe krahasimit të ofertave, por për çudi i njejti ka refuzuar kerkesen si te PA BAZUAR!

Të pakënaqur me Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar si dhe Njoftimin mbi Vendimin e AK për shpërblim me kontratë DOCTOR EXTERMINATOR DDD SHPK me datën 21.06.2024 nga Autoriteti Kontraktues në lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me nr.të prokurimit 214-23-13757-2-1-1, AK-MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME ka bërë:

-Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe

-Shkelje esenciale të dipozitave të LPP-së

Pas pranimit të letrës standarde dhe Njoftimin për Vendim-Shpërblim me kontratë kemi kërkuar nga AK qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë.
AK me datën 24.06.2024 na ka lejuar që të kemi qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë dhe pas kontrollit te dokumenteve vertetuam se i njejti nuk i plotëson kriteret e kërkuara dhe kemi ardhur ne perfundim se OE i rekomanduar eshte i papergjegjshem duke mos i plotesuar kriteret e NJK-së dhe DT-së, andaj kemi derguar kerkese per rishqyrtim pranë AK me date 25.06.2024 me pretendimet ankimore te paraqitura si më poshtë për secilën shkelje.

**PRETENDIMI 1**

Ne si GOE kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimi me çmimim prej 225,416.10 €, ndërsa OE të cilin AK ka shpërblyer me kontratë ka ofertuar me çmim prej 313,482.10 €, ku shihet se është një diferencë prej 88,068.00 Euro. Duke mos pasë parasysh kursimin e buxhetit publik siç e parasheh neni 1 dhe 6 të LPP-së, AK edhe pse me dëmtim buxheti për nje shume të majme sic e cekem më lartë deshiron te dëmtoje buxhetin publik dhe kjo për neve është shkelje e rëndë dhe njëkohësisht edhe diskriminim duke e shpërblyer me kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe duke na diskriminuar padrejtësisht.
AK Nenet e cekuara më lartë i shkel pa turp fare duke mos u munduar që fondet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike. Do të ishte krejt në rregull dhe konform LPP-së sikur vlerësimi i ofertave për të gjithë Operatoret të bëhet njëjtë duke mos i anashkaluar kriterert e përcaktuara në DT.

AK gjatë vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 7 të LPP-së duke na diskriminuar neve si ofertues dhe duke e shpërblyer me kontratë OE-në i cili nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT.

Me rastin e eliminimit tonë si grup i operatorëve në këtë aktivitet të prokurimit AK ka bërë shkelje të Nenit 1 dhe Nenit 6 të LPP-së

Gjatë vlerësimit të ofertave AK ka shkel Nenin7 të LPP-së. Diskriminimi i cili na është bërë neve si Grup i OE është se gjatë vlerësimit neve si GOE na ka kërkuar sqarime me datë 06.06.2024, ndërsa OE-në të cilin kanë shpërblyer me kontratë nuk i ka kërkuar asnjë sqarim edhe pse i njëjti ka shumë mangësi në dokumentet të cilat janë kërkuar në DT.

**Kërkesa për sqarim që na është bërë neve është si në vijim:**
1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide, ISO 14001 2015 valide, ISO 45001 2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit.
**Dëshmitë :**
1. Certifikatat ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, ISO 45001 2018 (kopje).
Ju për ketë kërkesë ne ofertën tuja keni prezantuar ISO standardet e lartcekura për OE Besim A. Zejnullahu B.I, por nuk keni ofruar ISO standardet për anëtarin e konzerciumit TRESOR HOME L.L.C.

Andaj bazuar në nenin 70 te LPP dhe paragrafin 26.6 te nenit 26 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik ,kërkojmë nga ana juaj që të na dërgoni kopjet e ISO standardeve për anëtarin e Konzerciumit TRESOR HOME L.L.C, sipas kërkesave ne dosjen e tenderit .

**Ne i kemi kthyer sqarimin si në vijim:**
Bazuar në Nenin 71.4 të LPP-së Ne si OE kemi dorëzuar me ofertë certifikatat e kërkuara në emër të grupit. Sipas këtij neni secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji,se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.
Në Nenin 71 te LPP-së është e cekuar se cka duhet të ofrojë secili anëtar i grupit dhe në këtë Nen nuk është cekur se kërkesa sipas nenit 70 do të aplikohet ndaj anëtarëve individual të grupit, po ashtu ju si AK në Dosje të tenderit këtë kërkesë e keni vendosur te **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** gjë që pasi që është vendosur në këtë fushë (Kapaciteti teknik-profesional), në rast se vetëm njëri nga anëtarët e konzorciumit do ta posedoj certifikatën apo certifikatat e kërkuara nënkupton se Grupi i OE-ve ështe i përgjegjshëm, pra ne si grup i posedojmë certifikatat e kërkuara.

Ju si AK dëshironi të respektoni paragrafin 26.6 të nenit 26 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik, me qëllim të eliminimit tonë në këtë AP, por po harroni se LPP është mbi këtë rregullore të cilin edhe duhet respektuar, dhe për ta dëshmuar këtë edhe OSHP merr vendimet duke i respektuar nenet e LPP-se, dhe nuk e vendos këtë rregullore mbi Ligjin e Prokurimit Publik.
Si dëshmi po ju dërgojmë dy vendime të OSHP-se që kanë rastin e njëjtë që kemi ne tani (për Certifikatat ISO kur ofertuesit janë si grup i operatorëve)
Dy vendime te OSHP-se jane te bashkangjitura ne kete kerkese. (Vendimi nr 2023/0642 të datës 08.12.2023dhe vendimi nr 2023/0626 të datës 03.11.2023)

Pjesë me rëndësi nga vendimi i OSHP-së nr 2023/0642 të datës 08.12.2023 ne faqe 7 ceket: Ekspertja shqyrtues fillimisht sqaron se neni 26.6 të cilit i referohet OE ankues vlen vetëm në rastet kur autoriteti kontraktues e përcakton në dosje të tenderit në mënyrë të prerë që secili prej anëtarëve të grupit duhet të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. "Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura...", sipas kësaj dispozite ligjore, AK-së i lejohet që të vendos NËSE kërkon që secili prej anëtarëve duhet të përmbush këto standarde përkatëse, ku në rastin konkret AK nuk e ka kërkuar një gje të tillë. Për më tepër, ekspertja shqyrtuese sqaron se neni 71, par. 4 i LPP-së përcakton se çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-së do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Në rastin konkret, kërkesa e vendosur në dosje të tenderit "3.Operatori duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ISO 9001,ISO 14001 dhe ISO 18001" bënë pjesë të mundësitë teknike dhe/ose profesionale, e cila kërkesë buron nga neni 69 i LPP-së.

Pjesë me rëndësi nga vendimi i OSHP-së 2023/0626 të datës 03.11.2023 ne faqe 4. Pretendimi i parë (I) ankimor është i pa bazuar pasi që "Eksperti sqaron se kjo kërkesë për ISO 28841 2013 në dosjen e tenderit ka qen e paraparë te kërkesat 9.1 & 9.2 e te cilat hyjnë te aftësia teknike dhe profesionale ma konkretisht te neni 69 i LPP-së ,në paragrafin 4 të nenit 71 specifikohet qartë se: çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. shih edhe Rregulloren Nr. 001/2022 për prokurim Publik Neni 26.5 si e rregullon dhe e qartëson ketë pretendim: 26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Eksperti sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse certifikata e theksuar më lart kërkohet vetëm ndaj grupit e jo nga secili anëtar i grupit siç pretendon OE ankues krejt bazuar në paragrafin 4 te nenit 71 të LPP-së dhe nenit 26.5 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim Publik"

**PRETENDIMI 2**

Gjatë vlerësimit të ofertave AK ka shkelur Nenin 59 te LPP-së, duke na diskriminuar ka bere shkeljen edhe te nenit 7 te LPP-se, duke na kërkuar neve si grup i operatorve sqarime ndërsa OE që keni shpërblyer me kontratë nuk i eshte kërkuar asnjë sqarim.
Sqarimi i cili na është kërkuar neve është si në vijim:" Ju për këtë kërkesë keni prezantuar një broshurë të produkteve dhe disa certifikata për analiza për preparatet e kërkuara dhe MSDS, andaj në mënyrë qe komisioni i vlerësimit të bëjë vlerësimin e drejtë të ofertave dhe te këtë më të lehtë vlerësimin dhe ekzaminimin e certifikatave te analizave dhe MSDS-t e, ju lutem që specifikoni ose markoni ose ndërlidhni artikujt e ofruar me broshurë me certifikatën e analizave (p.sh. në secilën certifikat te analizave të shënohet "certifikata për pozicionin 1 sipas katalogut ose broshurës, e njëjta vlen edhe për MSDS-të").

Ne i kemi dërguar sqarimin edhe pse cdo gjë ka qenë e sqaruar qysh me dorëzimin e ofertës dhe kjo dëshmohet edhe me listën e dokumenteve që është pjesë e ofertës në e-prokurim dhe ju si OSHP mund te verifikoni kete ne e-prokurim.

**Nëse bëni një krahasim të ofertës tonë të dërguar fillimisht, si dhe OE që AK ka shpërblyer me kontratë shihet haptas që nuk jemi trajtuar njëjtë.**

**PRETENDIMI 3**

AK duke na eliminuar neve padrjetësisht ka shpërblyer me kontratë një OE i cili nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT.

Kriteret e pa plotësuara janë si në vijim.

Në DT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2, pika 7 eshte kerkuar që
7. Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet të dëshmojë Katalog ose Broshurë me përshkrim teknik dhe foto për të gjithë preparatet e kërkuara dhe si dëshmi keni kërkuar që 7. Operatori Ekonomik (OE) , duhet të sjellë katalogët ose broshura për preparatet e kërkuara, Katalogët ose Broshurat, duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike dhe të jenë në përputhje me kërkesat në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

**OE i shpërblyer me kontratë nuk ka dorëzuar asnjë KATALOG apo BROSHURË që AK ka kërkuar**. (me dokumentet qe na ka ofru AK ne nuk kemi identifiku asnje dokument ne te cilin titullohet katalog apo broshure). Kjo mbetet qe ju si OSHP ta vertetoni ate se a posedon apo jo.

**PRETENDIMI 4**

Në DT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2, pika 8 AK ka kërkuar që Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmoj **Certifikatat e Analizave dhe MSDS për të gjitha preparatet e kërkuara te specifikimet teknike.**

OE i shpërblyer me kontratë nuk plotëson kriterin e cekur më lartë pasiqë në dokumentet e ofruara me ofertë mungojnë dokumentet për produktet si më poshtë:

***Te Aneksi 1. Te specifikimet teknike të deturueshme*** , faqe 21 e DT
Te Deratizimi , te **pika c**. Eshte kërkuar : OE duhet të përdorë preparate repelente adekuate kundër brejtësve (minjve) në formë të granulave apo sprej me origjine organike prej përbërësve NATYRORE dhe që nuk janë të rrezikshme për njerëzit dhe ambientin

OE. Doctor Exterminator DDD SHPK , te folderi Dosja Pjesa 5 nga faqja 27-31 ka ofruar dy preparate :
-Për preparatin Rodent Sherif sprej repellent ka ofruar vetëm SDS, **por – MUNGON CERTIFIKATA E ANALIZAVE**
Për preparatin NOW Solution –Castor Oil te folderi Dosja Pjesa 5 ,faqe 32-39 ka ofruar SDS dhe Certifikatën e Analizave por ky preparat në bazë të SDS së ofruar nuk dëshmon që është repellent por dëshmon se ky produkt është **Essential oils (vajra esenciale) .** Të njejtin emër të këtij ***preparati kam hulumtuar në internet*** dhe **ka rezultuar që është preparat për kozmetik.**

Dëshmia shiqoni faqën: *https://www.nowfoods.com/products/beauty-health/castor-oil*,ku shum mir cekët te përshkrimi se ky produkt është një zbutës natyral popullor i lëkurës që ndihmon në hidratimin dhe zbutjen e lëkurës dhe flokëve të shëndetshëm .

Në bazë të fotos të cilës ka ofruar OE Doctor Exterminator DDD te folderi Dosja Pjesa 5 te faqja 40 dhe asaj në internet :
Dëshmia shiqoni faqën : *https://www.nowfoods.com/products/beauty-health/castor-oil* shihet se qartë se OE. Doctor Exterminator DDD SHPK ka modifikuar foton dhe kjo është mashtrim ndaj autoritetit kontraktues qe me keto veprime apo mashtrime qe ka bere OE duhet te futet ne listen e zeze sipas nenit 99.2 te LPP-se, e jo te shperblehet me kontrate.







**Foto e prezentuar nga OE** **Foto e marruar nga web faqe e larteshenuar**

**Në paketim shenon :100 % pure versatile skin care, skin softener multi-purpose**
**Nëse përkthehet në gjuhën shqipe : 100% kujdes i gjithanshëm për lëkurën, zbutës shumëfunksional i lëkurës**

**PRETENDIMI 5**

***Te Aneksi 1. Te specifikimet teknike të deturueshme*** , faqe 21 e DT
Te Dezinsektimi , te pika g, AK ka kërkuar në disa hapësira gjelbëruese përreth objekteve, me qellim të largimit të insekteve duhet të përdoren preparate repelente kundër insekteve në forme të granulave.Repelentet mund të jenë edhe ekuivalnte (në formë spreji,likuid , koncetrat)
OE. Doctor Exterminator DDD SHPK si repelent për insekte ka ofruar dy preparate si në vijim:
1.Si repelent për insekte te folderi Dosja Pjesa 4 ,faqe 28 -34 ,ka ofruar preparatin -Mighty Mint Insect & Pest control vetëm SDS – **por MUNGON CERTIFIKATA E ANALIZAVE** për këtë preparat ,
**2.**Ndërsa si repelent tjeter për insekte ka ofruar preparatin Peppermint Essential oil ,ku për këtë preparat te folderi Dosja Pjesa 2, faqe 72-73 OE i shpërblyer me kontratë ka shenuar kështu :
Nature in Bottle -Peppermint Oil për repelimin e insekteve të padëshirueshme Vaji i mentes është njohur si vaj me përdorim të shumëfishtë por gjithashtu është i njohur si repelent për aromën e tij të fortë ,të cilën insektet e konsiderojnë të pakëndshme. Përzierja e 50 ml me

20 ml ujë mund të krijojë një spërkatje efektive për ti mbajtur insektet larg zonave të dëshiruara (të nënshruar dhe të vulosur) .
Sipas hulumtimeve në internet produkti Peppermint Essential Oil me të cilën OE ka ofruar SDS dhe Certifikaten e Analizave (te folderi Dosja Pjesa 4 faqe 38-47, të cilat i ka gjeneruar nga interneti).Në përshkrim të këtij produkti ceket se vaji esencial i mentës është produkt që bën pjesë në aplikime të shumta të bukurisë, kozmetikës, aromaterapisë dhe sapunit, gjithashtu i nderuar për vetitë e tij të shumta terapeutike dhe është i dobishëm kur kërkoni të reduktoni bakteret dhe viruset e padëshiruara, si dhe të reduktoni dhimbjen dhe inflamacionin,**përdoret për të qetësuar lëkurën nga pickimi i insekteve**.
**Do me thën ky produkt nuk është produkt që i mban insektet larg zonave të dëshiruara (ashtu siq ka thën OE )dhe të përdoret për largimin e insekteve siq është kërkuar në DT**
Prove –Dëshmia
Për më tepër shiqoni: *https://www.natureinbottle.com/product/peppermint_essential_oil.*
Po në të njëjtën faqe mund të gjeneroni edhe SDS-në dhe Certifikaten e analizave.
***Pra operatori i lartëpërmendur sërish ka dashur ta mashtroj Autoritetin kontraktues.***

**PRETENDIMI 6**

*Te Aneksi 1.Te specifikimet teknike të deturueshme faqe 22 e DT* është kërkuar: Parandalim i zhvillimit/largimi i dëmtuesve tjerë dhe atë si : gjarpërinjve, zvarranikeve të ndryshme, shpezëve etj te pika: I) Për largimin e shpendëve duhet të përdoren preparate repelente në formë të gellit me përmbajtje Canfora oil ose ekuivalente

**OE. Doctor Exterminator DDD SHPK**, te folderi Dosja Pjesa 5 nga faqja 53 deri te faqja 73 ka ofruar SDS për dy preparate JT Eaton Tranparent 4 the Bird repellent (si preparat në formë të gellit i cili është kërkuar në DT ) dhe JT Eaton Transparent 4 the Bird repellent likuid (si preparat i në formë të lëngut i cili nuk është kërkuar në DT) .
Mirëpo OE në fjalë nuk ka ofruar **CERTIFIKATEN E ANALIZAVE për asnjërin nga këto dy preparate (pra mungon Certifikata e Analizave për preparatin repellent të shpendëve)**

**PRETENDIMI 7**

Në DT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2, pika 9 keni kerkuar që: Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë duhet te kenë te përfunduar kontrata për shërbimet të ngjashme, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo më pak se 200,000.00 €, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë dhe si dëshmi keni kerkuar : Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës,(certifikatave)ose referencës,të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e caktuara në listë

Në bazë të dëshmive që i ka ofruar OE i shpërblyer me kontratë sjellë në pah se edhe ju si AK gjatë vlerësimit i keni mbyllur sytë dhe nuk i keni analizuar mirë listen e kontratave, Marrëvshjet e ofruara dhe Referencat e këtij Operatori që keni shperblyer me kontratë. Është fjala për kontratën e cila është nënshkruar mes juve si AK dhe një OE tjetër me datë 29.10.2020, për aktivitetin e prokurimit me numër 214-20-5999-2-1-1.

Në këtë kontratë faqe 5, neni 4 – Nën-kontraktimi, te pika 4.2 është e shenuar:
Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nën kontraktuesve gjatë implementimit të kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

Në të njëjtën ditë të nënshkrimit të kësaj kontrate, nënshkruhet edhe mareveshja për bashkepunim në mes të DOCTOR EXTERMINATOR DDD SHPK dhe OE fitues dhe nënshkruesi i kontratës 214-20-5999-2-1-1 të datës 29.10.2020.

Është për tu habitur se si ky detaj është anashkaluar nga ana e AK, ku OE i shpërblyer me kontratë së bashku me OE të kontratës me numër 214-20-5999-2-1-1 kanë vepruar në kundërshtim me nenin 4.1 të kësaj kontrate.

**PRETENDIMI 8**

Lidhur me shkeljet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim, ju sqarojmë se AK ka berë shkeljen e nenit 108A të LPP-së, pasi që nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, pasi që është munduar të na lajthitë në pergjigjëje e që do ti paraqesim si në vijim:

- **Te pretendimi i parë** i K,Rishqyrtim, AK nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore duke mos i marrur parasysh provat e paraqitura nga ana jonë si ankues, konkretisht Vendimet e OSHP-se.Vendimi nr 2023/0642 të datës 08.12.2023 dhe vendimi nr 2023/0626 të datës 03.11.2023, ku i gjeni të elaboruar në Pretendimin nr.1 të kësaj ankese, poashtu ne ja bashkangjesim edhe një Interpretim Ligjor të KRPP-së të datës 07.06.2024 me nr.KRPP-DRR-07-06-88/2024, ku veq tjerave thotë se:
  Në përputhje me nenin 17.12 të RRPP-ës, "Në dosjen e tenderit AK do të deklaron **të gjitha informatata relevante** për kontratën në fjalë që OE-ve të interesuar duhet të dijnë për përgaditjen e tendereve pa kërkuar informata shtesë. Informatat e tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjinë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj, të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasiqë dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgaditet në mënyrë të tillë, që si-rregull primar të mos ketë nevojë për infomata sqaruese shtesë..."

Pra, bazuar në këtë interpretim thotë shumë qartë se AK e ka përgjegjësi që çdo fjali në dosjen e tenderit duhet të përpilohet mirë, dhe AK te kriteri i kerkuar konkretisht te pika 9.1 & 9.2 e DT-se kërkon:

| | |
|---|---|
| 1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. | 1. Certifikata ISO 9001 2015 (kopje). |

| | |
|---|---|
| 2. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 14001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. | 2. Certifikata ISO 14001 2015 (kopje). |
| 3. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 45001 2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. | 3. Certifikata ISO 45001 2018 (kopje). |

Bazuar në këtë kriter AK nuk e ka specifikuar se çdo anëtar i grupit të jetë i pajisur me Certifikata ISO, pra pikërisht bazuar në kriterin e DT-së, është kriter i kërkuar te kapaciteti teknik dhe profesional, dhe pikërisht pasi që është i vendosur në këtë nen 69 të LPP-së, lejohet që një OE të mbështet me kapacitet një OE tjetër siq e sqaron paragrafi 8 i nenit 69 te LPP-së.
Pra, edhe AK nuk e ka sqaruar siq duhet ,këtë e vërteton edhe interpretimi i KRPP-së i dt.07.06.2024 të paraqitur si me lartë, ashtu siq e thotë edhe neni 53.6 i LPP-së se AK nuk mund të diskualifikohet një OE për kritere që nuk janë kërkuar qartësisht në DT.

ANDAJ, Ju rikujtojmë se AK në këtë AP kërkesën për Certifikatat ISO i ka vendosur në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2 e te cilat hyjnë te neni 69 i LPP-së si dhe ka cekur **OPERATORI EKONOMIK OSE GRUPI I OPERATOREVE EKONOMIK.**

- Autoriteti poashtu nuk i ka shqyrtuar pretendimet tona ankimore duke mos i marr parasysh provat tona konkretisht shkeljen e nenit 1 dhe 6 të LPP-së demtimi i buxhetit publik, ku ne kemi në këtë aktivitet të prokurimi me çmimim prej 225,416.10 € ndërsa OE të cilin AK ka shpërblyer me kontratë ka ofertuar me çmimin prej 313,482.10 €, ku shihet se është një diferencë prej **88,068.00 Euro**. AK duke mos pasë parasysh kursimin e buxhetit publik siç e parasheh neni 1 dhe 6 të LPP-së, AK edhe pse me dëmtim buxheti për një shumë të majme sic e cekëm më lartë është shkelje e rëndë dhe njëkohësisht edhe diskriminim duke e shpërblyer me kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe duke na diskriminuar padrejtësisht.
- **Po ashtu siq eshte potecuar te pretendimi 2** gjatë vlerësimit të ofertave AK ka shkelur Nenin 59 te LPP-së, duke na diskriminuar ka bere shkeljen edhe te nenit 7 te LPP-se, duke na kërkuar neve si grup i operatorve sqarime ndërsa OE që ka shpërblyer me kontratë nuk i eshte kërkuar asnjë sqarim. Ne i kemi dërguar sqarimin edhe pse cdo gjë ka qenë e sqaruar qysh me dorëzimin e ofertës dhe kjo dëshmohet edhe me listën e dokumenteve që është pjesë e ofertës në e-prokurim dhe ju si OSHP mund te verifikoni kete ne e-prokurim.

- **Poashtu vlen të potencohet se AK nuk e ka shqyrtuar pretendimin nr.3, ku ne kemi argumentuar në bazë të qasjes që na është ofruar pikërisht nga AK-MPB, se OE i shpërblyer me kontratë nuk ka dorëzuar asnjë KATALOG apo BROSHURË që AK ka kërkuar** (me dokumentet qe na ka ofruar AK ne nuk kemi identifikuar asnjë dokument në të cilin titullohet katalog apo broshure). Kjo mbetet që ju si OSHP ta vërtetoni atë se a i posedon apo jo, sepse AK nuk e ka marrë fare parasysh pretendimin dhe duke mos na argumentuar fare me atë që është pergjigjur dhe ëtë që e posedon OE. Doctor Exterminator DDD.

- **Te pretendimi nr.4**, konkretisht te preparati Rodent Sherif, në këte rast AK ka vepruar me standarte të dyfishta ku në DT , te kriteret e kërkuara, po ashtu edhe te

specifikimet teknike qe i ka kërkuar për të gjitha preparatet, thotë shum qartë se: OE duhet të dëshmoj Certifikatat e Analizave dhe MSDS.

Për preparatin Rodent Sherif sprej repellent ka ofruar vetëm SDS, por – MUNGON CERTIFIKATA E ANALIZAVE, ndërsa AK ka arsyetuar se "kompania prodhuese nuk ofron certifikatë të analizës por MSDS në të cilën specifikon përbërjen e saktë të produktit dhe tregon qëllimin e përdorimit në repelimin e brejtësve ndërsa te preparati "NOW Solution castor oil", AK përvëq që nuk e ka hulumtuar në faqen e internetit preparatin në fjale, është munduar ta arsyeton OE e rekomanduar. Për ta vërtetuar preparatin e ofruar nga OE i rekomanduar kliko ne linkun: https://www.nowfoods.com/products/beauty-health/castor-oil, ku shumë qartë sqarohet nga prodhuesi se si dhe ku mund të përdoret ky preparat, por AK ka mbrojtur haptazi OE duke dhënë sqarime për Vajin i ricinit e jo për praparatin me të cilin ka ofruar OE i shpallur fitues, SEPSE Vaji i ricinit i prezantuar nga OE i rekomanduar nuk është preparat që kërkohet në DT (Produkt për largimin e brejtësve-minjëve), kurse OE e ka ofruar preparatin i cili është produkt i kozmetikës, ashtu siq është elaboruar në pretendimin nr.4. ANDAJ, AK nuk i ka marr fare parasysh provat që i kemi ofruar sipas linkut për produktin e njëjtë, ku OE ka bërë mashtrim te AK-së ku OE i rekomanduar e ka prerë(modifikuar) ETIKETEN E PREPARATIT, ashtu siq e kemi sqaruar në pretendimin nr.4.

- Me arsyetimin e dhënë AK ngjan që AK eshte shume jo profesionale apo don te favorizoje OE qe eshte shperbly me kontrtete. MASHTRIMI po shihet haptas për të gjithe ata që dëshiroje të shohin drejt, por është për tu habit me AK se si e ka leju një gjë të tillë!

- **Poashtu edhe te pretendimi nr.5** AK nuk i ka shqyrtuar pretendimet Siq janë kerkuar te specifikimi teknik si: repelent për insekte te folderi Dosja Pjesa 4 ,faqe 28 -34 , ka ofruar preparatin -Mighty Mint Insect & Pest control vetëm SDS – **por MUNGON CERTIFIKATA E ANALIZAVE** për këtë preparat , **por AK është pajtuar vetëm me dokumentet që i ka prezantuar OE i rekomanduar duke mos e plotësuar kriterin e kërkuar të DT-së,për më tepër referoju pretendimit nr.5, ku edhe te ky produkt OE ka mashtruar AK dhe AK e ka mbrojtur haptazi OE edhe në këtë pikë duke e arsyetuar si në pretendimin nr.4 dhe nr.5.**

Sipas hulumtimeve në internet produkti Peppermint Essential Oil me të cilën OE ka ofruar SDS dhe Certifikatën e Analizave. Në përshkrim të këtij produkti ceket se vaji esencial i mentës është preparat që bën pjesë në aplikime të shumta të bukurisë, kozmetikës, aromaterapisë dhe sapunit, gjithashtu i nderuar për vetitë e tij të shumta terapeutike dhe është i dobishëm kur kërkoni të reduktoni bakteret dhe viruset e padëshiruara, si dhe të reduktoni dhimbjen dhe inflamacionin,përdoret për të qetësuar lëkurën nga pickimi i insekteve. Do me thën ky produkt nuk është produkt që i mban insektet larg zonave të dëshiruara (ashtu siq ka thën OE )dhe të përdoret për largimin e insekteve siq është kërkuar në DT
Prove–Dëshmia, *https://www.natureinbottle.com/product/peppermint_essential_oil*.
Po në të njëjtën faqe mund të gjeneroni edhe SDS-në dhe Certifikaten e analizave.
Pra operatori i lartëpërmendur sërish ka dashur ta mashtroj Autoritetin kontraktues.

**Poashtu edhe te pretendimi nr.6** OE në fjalë nuk ka ofruar **CERTIFIKATEN E ANALIZAVE për asnjërin nga këto dy preparate (pra mungon Certifikata e Analizave për preparatin repellent të shpendëve), por ka ofruar MSDS, dhe AK e arsyeton se në MSDS është cekur përmbajtja e prokuktit, ku AK nuk iu ka**

**përmbajtur fare kërkesës sëe DT-së që është kërkuar pikërisht nga vet AK-ja. Ndërsa si preparat të tretë për largimin e shpezëve OE ka ofruar** Peppermint Essential Oil (e shenuar sipas AK "Nature in Bottle" ) për të cilin preparat AK ka shenuar se sipas hulumtimeve të tyre është gjet se Peppermint Essential Oil (Vaji i entes) është një mënyre natyrale dhe efektive për të larguar zogjtë nga zonat e padëshiruara.
Ky preparat i ofruar nga OE siq është cekur edhe në pretendimin nr 5 nuk është preparat për largimin e shpendëve, për më tepër deshmi prova: *https://www.natureinbottle.com/product/peppermint_essential_oil*.

- **Po ashtu edhe te pretendimi nr.7** AK nuk e ka vërtetuar kontratën siq kemi pretenduar ne si OE ankues, ku OE i rekomanduar dyshojmë se me vetëdije e ka mashtruar AK ku me gjerësisht është elaboruar në pretendimin nr.7 e që AK nuk e ka shqyrtuar fare këtë kontratë që dyshohet të jetë këq përdorur nga Operatori, sepse në të njëjtën ditë të nënshkrimit të kësaj kontrate, nënshkruhet edhe mareveshja për bashkepunim në mes të DOCTOR EXTERMINATOR DDD SHPK dhe OE fitues dhe nënshkruesi i kontratës 214-20-5999-2-1-1 të datës 29.10.2020. Ku nuk është cekur në kontrate që do të ketë nënkontraktor apo jo??

  Këtë mund ta vertetoni shumë lehtë ju si OSHP dhe të merrni një vendim të merituar dhe jo diskriminues ndaj neve si GOE. ANDAJ, nga sqarimet e dhëna si më lartë në të gjitha pikat e kësaj ankese shihet se ka një mashtrim dhe se AK nuk i ka sqaruar dhe se aspak nuk nderlidhet marrëveshja e bashkëpunimit për kryerjen e shërbimit siq e sqaruam edhe më lartë, ANDAJ ju sugjerojmë që këtë duhet ta vërtetoni pasi që nga kontrata e njejtë e pranuar (shkarkuar) nga E-prokurimi kemi ardhur në përfundim: ***Ne dosjen e OE së rekomanduar është një marrëveshje bashkëpunimi në mes të OE të shpallur fitues dhe OE tjetër (DDD SHPK) ku nga ky hulumtim dhe analize që i kemi bërë kësaj marrëveshje dhe kontratës së AK-së, rezulton se DDD i ka lëshuar referencë DOCTOR EXTERMINATOR, kurse në kontratën e nënshkruar në mes AK - MPB-së dhe OE. DDD SHPK nuk ceket askund qe ky kontraktor ka deklaruar nënkontraktor për projektin me nr. 214-20-5999-2-1-1.***

**-Pra, për të gjitha këto shkleje të bëra nga AK në drejtimin tonë, ne si OE ankues shpresojmë që do të ketë drejtësi nga ju si OSHP dhe të shqyrtoni ankesën konform provave dhe argumenteve në të kundërten ne do të detyrohemi ti drejtohemi Organeve tjera Kompetente.**

Nga të cekurat më lartë të cilat janë evidente, të prekshme kërkojmë nga OSHP të merr :

**V E N D I M**

**1. APROVOHET si e bazuar** *ankesa* **e GOE."Besim A.Zejnullahu B.I ; TRESOR HOME L.L.C "** lidhur me tenderin **Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender"** me nr.të prokurimit **214-23-13757-2-1-1**

**2.ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës dhe** lënda të kthehet **në rivlersim.**

**3. SHPËRBLEHEMI me kontratë ne si GOE i përgjegjshëm pasi që ne i plotësojmë kriteret e kërkuara te DT-së dhe të shpërblehemi me kontratë.**

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

| |
|---|
| **Demet e konstatuara deri me tani kapin shume rreth 2,000 €** |

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*